



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim  
Agencija Kosova za Akreditaciju  
Kosovo Accreditation Agency



Data: 06/04/23 Ref.: 436/23

Në mbështetje të nenit 8 dhe 12 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr. 05/L-31, nenit 7 dhe 15 të Ligjit Nr.04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, Udhëzimin Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, si dhe Manualin e Akreditimit (*përditësuar me vendimin Ref.932/22*), Këshilli Shtetëror i Cilësisë i Agjencisë së Kosovës për Akreditim, në mbledhjen e 110-të, të mbajtur më 28.03.2023, mori:

### V E N D I M

- I. Nuk riakreditohet Akademia e Kosovës për Siguri Publike në nivel institucional.
- II. Ndalohet regjistrimi i studentëve të rinj për të gjitha programet e studimit që kanë akreditim valid në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike për vitin akademik 2023/2024 deri në përfundimin e procesit ri (të dytë) të akreditimit.
- III. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

### A R S Y E T I M I

Akademia e Kosovës për Siguri Publike ka parashtruar kërkesë me Nr.prot.1835/22, datë 27.10.2022, pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (në tekstin e mëtejme AKA) për riakreditim në nivel institucional.

AKA ka organizuar vizitë me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Akademia e Kosovës për Siguri Publike me qëllim të vlerësimit në nivel institucional. Vizita është organizuar me datë 24.02.2023, me ekipin e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit me përbërje: Melita Kovacevic dhe Peter Parycek.

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, Ekipi i Vlerësuesve të jashtëm (Ekspertëve ndërkombëtar) ka hartuar raportin e vlerësimit dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka konstatuar se nga njëmbëdhjetë (11) fushat e standardeve të akreditimit, Akademia e Kosovës për Siguri Publike është vlerësuar se përmbushë:

- Plotësisht, zero (0) standarde;
- Substancialisht katër (4) standarde;
- Pjesërisht katër (4) standarde;
- Nuk i plotëson standardet tre (3) standarde.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë në mbledhjen e 110 të mbajtur më 28.03.2023 ka shqyrtuar kërkesën e Akademisë së Kosovës për Siguri Publike dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitës si dhe në rekomandimin përfundimtar të dhënë në raportin final të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, citojmë: *“According to the expert team's evaluation, KAPS is “non-compliant” with the standards included in the KAA Accreditation manual and, therefore, the expert team does not recommend to re-accredit the institution.”* vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.”

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi pala mund të parashtoj ankesë sipas Ligjit Nr.05/L-031 mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative në organin që ka nxjerrë këtë vendim, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar.

Vendimi ju dërgohet :

- Akademisë së Kosovës për Siguri Publike;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.

  
  
Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi  
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë